



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË

PRANITJE E
ACTA NOTORIALI
PESHKIMIA
Nr.No.Br. 02/146
16-05-2018

Komisioni Komunal për Dhënie në Shfrytëzim të
Pronës së Paluajtshme Komunale.
Nr. 02/
Dt. 16.05.2018

Në bazë të nenit 5 të Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 7 të Rregullores QRK nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës Nr.02/140 për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pishinës Publike në Fshatin Banjë,

Komisioni Vlerësues për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale, më datë 16.05.2018, shpall:

**NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR, TË PRONËS SË PALUAJTSHME
KOMUNALE- PISHINËS PUBLIKE NË FSHATIN BANJË**

EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

- Komuna Malishevës – Komisioni Vlerësues për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale;
- Adresa Rr."Gjergj Kastrioti – Skenderbeu", p.nr;
- Kodi Postar Malishevë 24 000.

LËNDA E ANKANDIT

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Malishevës, në bazë të Vendimit Nr.02/140, datë 14.05.2018 ka përcaktuar si qëllim dhënie shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale "Pishina Publike në Fshatin Banjë" personave juridik dhe personave fizik në afat deri me **31.12.2018** nga dita e nënshkrimit të kontratës, përmes ankandit publik, procedura përmes ofertave të mbyllura.

Dhënie në shfrytëzim afatshkurtër (afati sipas Vendimit Nr.02/140, datë 14.05.2018) e pronës së paluajtshme komunale si vijon:

1. Prona publike e lartëcekur ndodhet në pjesën e Zonës Kadastrale në fshatin Banjë, KK-Malishevës, në sipërfaqe të përgjithshme prej 5147 m², e cila gjendet në pjesën e ngastrës kadastrale Nr.P-7231001-01692-1, në vendin e quajtur "Bazhlina te Bazeni", pronë publike në emër të KK-Malishevës.

KRITERET E PËRGJITHSHME

1. Kriteri i dhënies së kontratës: Oferta më e favorshme ekonomike dhe me çmimin më të lartë;
2. Çmimi fillestar është **18,000.00 € (tetëmbëdhjetë mijë euro)**;
3. Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës është deri me **31.12.2018** nga dita e nënshkrimit të kontratës;
4. Veprimtaria që ushtrohet në hapësirat e dhëna në shfrytëzim është kryesisht veprimtari rekreative dhe biznesi brenda hapësirave të përkufizuara sipas udhëzimeve të Drejtorisë për Shërbime Publike;
5. Sipas Vendimit Nr.02/140, datë 14.05.2018 të Kuvendit Komunal Malishevë, fituesi i Ankandit duhet të lirojë nga pagesa këto kategori (Familjet e Dhëshmorëve, Invalidët e Luftës, Pensionistët, Familjet me Asistencë Sociale dhe Klubi i Notit "Besa").

INFORMATA ADMINISTRATIVE

1. Afati kohor i fundit për tërheqjen e dokumentacionit nga ankandi: **data 14.06.2018 ora 15.00**;
2. Afati i kohor i fundit për pranimit-dorëzimin e Aplikacioneve: **data 18.06.2018 ora 12.00**;
3. Vendi i dorëzimit të ofertave të ankandit publik: Komuna Malishevës, Qendra për Shërbime të Qytetarëve –Shkresorja e Komunës;
4. Takimi për hapjen e Aplikacioneve është publik dhe do të bëhet më datë **18.06.2018, ora 14.00**;
5. Ofertat hapen publikisht në sallën e Kuvendit Komunal – Malishevë të cekur si në pikën 4;
6. Ofertat duhen dorëzuar të mbyllura në zarf dhe të njëjtat te regjistrohen sipas procedurës së pranimit të shkresave;
7. Informacionet shtesë mundë t'i kërkonit përmes zyrtarëve të Drejtorisë për Shërbime Publike;
8. Ofertat e mbyllura (dy kopje) në formë fizike dorëzohen në Shkresoren e Komunës së Malishevës.

Këshilla Juridike:

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë të Komisioni për Ankesa në Komunën e Malishevës, sipas dispozitave të nenit 9 pika 3 të Ligjit Nr. 04/L-144, Ligji për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale.

Komisioni Komunal për Dhënie në Shfrytëzim të
Pronës së Paluajtshme Komunale Malishevë

Kryesuesi i Komisionit

Bashkim Krasniqi

